




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.893/ 756 regjistri, datë 30.5.2014.
 Nr.632 vendimi, datë 20.7.2015.



V E N D I M
 NË
“EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata administrative e shkallës së parë Shkodër e përbërë nga :

Ahmet JANGULLI GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Entela Hasmujaj, në Shkodër në datën 20.7.2015, shqyrtoi në seancë gjyqësore/ të hapur, çështjen administrative nr.893/ 756 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

Shoqëria “GENTI” SHPK sh.p.k, e identifikuar me Nipt in J67902353F, me seli Lezhë Mamurras MAMURRAS Lagjia “Zef Hotii”, me status Pezulluar. Me përfaqësuese ligjore znj. Drane Boçi.

E përfaqësuar në gjykim nga znj. Drane Boçi/ e njojur me letërnjoftimin me nr.025226576 e me nr. personal F55303067E.

E mbrojtur në gjykim/ me prokurën e posaçme me nr.1687 rep, e me nr.1291 kol, datë 13.5.2015, nga av. Agim Ibraj/ me nr. Leje 771 e me nr. Nipt i L57506503O.

Të paditur :

1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.467 prot, datë 8.6.2015, nga juristi z. Isidor Frashni/ i njojur me pasaportën biometrike me nr. BR8480370 e me nr. personal I51212068D.

2. Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.18220/ 1 prot, datë 5.6.2015, nga juristi z. Isidor Frashni/ i njojur me pasaportën biometrike me nr. BR8480370 e me nr. personal I51212068D.



2.1. pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ padinë e mësipërme (bëhet fjalë për padinë e paraqitur për regjistrim), dhe duke mos i bashkëngjitur asaj/ asnjë lloj akti.

2.2. padia është hartuar në shtatë fletë formati A-4, dhe pala paditëse/ është paraqitur para gjykatës, duke kërkuar:

“Kërkoj pavlefshmëri absolute të akteve administrative:

1. Raport kontrolli nr.5856/3 datë 28.1.2014.
2. Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.5856/8 prot datë 19.2.2014.
3. Vendimin e drejtorisë së Apelimit Tatimor nr.7366/1 datë 29.4.2014

për

Detyrimet tatimore në vleren	62.149.129 lekë
Kamat vonesë në vleren	24.452.102 lekë
Gjobë në vleren	73.579.422 lekë

Vlera në total 160.180.653 lekë.” (objekti i padisë);

“Asnjë lloj kërkimi konkret” (arsyetimi i padisë);

dhe,


“Asnjë lloj kërkimi konkret” (kërkimi në fund të padisë).

2.2.1. në kërkimin që trajton padia e mësipërme, me atë objekt padie, me parashtrimin në arsyetimin e saj, dhe me kërkimin e konkluduar që trajton padia, nuk mund të konceptohet se çfarë po kërkon pala paditëse, në raport me veprimet apo mosveprimet administrative të kryera nga pala e paditur drt ja Lezhë, në raport me aktin administrativ objekt gjykimi, duke konsideruar ligjin procedural (ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe k.pr.civile).

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 29.5.2014/ nëpërmjet shërbimit postar. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

4. Në datën 13.5.2015/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t'i dëgjuar.

4.1. në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 13.5.2015, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t'a plotësuar atë në elementët e saj, sipas vendimit kthim për plotësim të datës 13.5.2015/ duke i lënë një afat kohor prej 5 ditësh, dhe për këtë arsy e ndërprenë veprimet përgatitore. Në këtë vendimmarje gjykata ka qenë në unison të plotë edhe me vullnetin e palës paditëse, “duke gjetur mirëkuptim në orientimin që u dha nga gjykata në seancë/ e në kohën që u la për të plotësuar padinë në të metat e saj” (për më tepër p-v i seancës dhe vendimi kthim për plotësim).



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 11.08.2015

